FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 82 — 17 korrik — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 24/2012, datë 21.6.2012	Për vijimin e punës së komisionit të posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore, të ngritur me vendimin nr. 141, datë 17.11.2011	3725
Vendim i Kuvendit nr. 25/2012, datë 28.6.2012	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e Ministrit të Brendshëm	3725
Vendim i Kuvendit nr. 26/2012, datë 28.6.2012	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Ministrit të Brendshëm	3726
Vendim i Kuvendit nr. 27/2012, datë 28.6.2012	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e Ministrit të Punëve të Jashtme	3736
Vendim i Kuvendit nr. 28/2012, datë 28.6.2012	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	3727
Vendim i Kuvendit nr. 29/2012, datë 28.6.2012	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e Ministrit të Shëndetësisë	3727
Vendim i Kuvendit nr. 30/2012, datë 28.6.2012	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	3728
Vendim i Kuvendit nr. 31/2012, datë 28.6.2012	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Ministrit të Punëve të Jashtme	3728
Vendim i Kuvendit nr. 32/2012, datë 28.6.2012	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Ministrit të Shëndetësisë	3729

Vendim i Kuvendit nr. 33/2012, datë 28.6.2012	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 4, datë 16.9.2009 "Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve, byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit", të ndryshuar	3729
Vendim i Kuvendit nr. 34/2012, datë 28.6.2012	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 "Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar	3730
Vendim i KM nr. 389, datë 30.5.2012	Për autorizimin e Ministrisë së Financave për përdorimin e fondeve nga llogaria e shpronësimeve për ekzekutimin e vendimit nr. 44, datë 17.3.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, me objekt "Kthim shumën nga shpronësimi, si dhe dëmshpërblim"	3730
Vendim i KM nr. 390, datë 6.6.2012	Për përcaktimin e subjekteve që kanë të drejtën e aksesit në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSREP)..	3732
Vendim i KM nr. 393, datë 20.6.2012	Për revokimin e vendimit nr. 285, datë 4.5.2007 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik, që kryejnë punë të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues e tekniko-ekonomik të tyre"	3733
Vendim i KM nr. 394, datë 20.6.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Avokatin e Popullit, për financimin e Konferencës së Ombudsmanëve të Vendeve Frëngjishtfolëse, që zhvillohet në Tiranë, në tetor 2012	3733
Vendim i KM nr. 395, datë 20.6.2012	Për trajtimin e viktimave të trafikimit dhe përfitimin e shërbimeve shëndetësore nga kjo kategori	3734
Vendim i KM nr. 396, datë 20.6.2012	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike të Tufinës, faza II, në bashkinë e Tiranës..	3735
Vendim i KM nr. 399, datë 20.6.2012	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.3.2012, për çështjen nr. 10810/05 "Çaush Driza kundër Shqipërisë"	3736
Vendim i KM nr. 401, datë 20.6.2012	Për krijimin e Akademisë së Arteve, Shkodër	3737
Vendim i KM nr. 404, datë 20.6.2012	Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse	3738
Vendim i KM nr. 408, datë 27.6.2012	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor bulevardi "Bajram Curri" deri në rrugën "Ali Demi", faza e dytë	3740

Vendim i KM nr. 410, datë 27.6.2012	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës	3744
Vendim i KM nr. 411, datë 27.6.2012	Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të znj. Esmeralda Uruçi	3748
Urdhër i KM nr. 78, datë 2.7.2012	Për emërim në detyrë	3749
Vendim i ERE nr. 73, datë 13.6.2012	Për fillimin e procedurave "Për miratimin e studimit të borxhit të keq"	3749
Vendim i ERE nr. 74, datë 15. 6.2012	Për licencimin e shoqërisë "Albpetrol" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	3750
Vendim i ERE nr. 75, datë 15.6.2012	Për licencimin e shoqërisë "Albpetrol" sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike	3751
Vendim i ERE nr. 76, datë 15.6.2012	për licencimin e shoqërisë "Lu & Co Eco Energy 2011" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Ostren i vogël"	3751
Vendim i ERE nr. 77, datë 15.6.2012	Për licencimin e shoqërisë "Albanian Power" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	3752
Vendim i ERE nr. 78, datë 15.6.2012	Për kualifikimin e impiantit prodhues "Hec Martanesh" të shoqërisë "Albanian Power" si burim i rinovueshem energjie	3753
Vendim i ERE nr. 79, datë 15.6.2012	Për miratimin e dokumentit "Ftesë për shprehje interesi" që do të shpallet nga TAP AG në përputhje me udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të Projektit Transadriatik Pipeline (TAP), sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC	3754
Vendim i ERE nr. 80, datë 15.6.2012	Mbi miratimin e studimit për borxhin e keq	3755
Vendim i ERE nr. 81, datë 22.6.2012	Për fillimin e procedurave për rishikimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80, datë 15.6.2012 të bordit të komisionerëve të ERE-s	3756
	Vendim për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Luan Sadikaj	3757
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Florinda Hoti .	3757

VENDIM
Nr. 24/2012

PËR VIJIMIN E PUNËS SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN ZGJEDHORE, TË NGRITUR ME VENDIMIN NR. 141, DATË 17.11.2011

Në mbështetje të neneve 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Vijimin e punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, të ngritur me vendimin nr. 141, datë 17.11.2011, deri në datën 12.7.2012.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 21.6.2012

VENDIM
Nr. 25/2012

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7550, datë 22.6.2012 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7550, datë 22.6.2012, për shkarkimin e zotit Bujar Nishani nga detyra e Ministrit të Brendshëm.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 26/2012

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7558, datë 25.6.2012 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7558, datë 25.6.2012, për emërimin e zotit Flamur Noka në detyrën e Ministrit të Brendshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 27/2012

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË PUNËVE TË JASHTME

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7552, datë 25.6.2012 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7552, datë 25.6.2012, për shkarkimin e zotit Edmond Haxhinasto nga detyra e Ministrit të Punëve të Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 28/2012

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7553, datë 25.6.2012 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7553, datë 25.6.2012, për shkarkimin e zotit Nasip Naço nga detyra e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 29/2012

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT TË SHËNDETËSISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7554, datë 25.6.2012 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7554, datë 25.6.2012, për shkarkimin e zotit Petrit Vasili nga detyra e Ministrit të Shëndetësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 30/2012

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7555, datë 25.6.2012 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7555, datë 25.6.2012, për emërimin e zotit Edmond Haxhinasto në detyrën e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 31/2012

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË PUNËVE TË JASHTME

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7556, datë 25.6.2012 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7556, datë 25.6.2012, për emërimin e zotit Edmond Panariti në detyrën e Ministrit të Punëve të Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 32/2012

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E MINISTRIT TË SHËNDETËSISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 7557, datë 25.6.2012 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 7557, datë 25.6.2012, për emërimin e zotit Vangjel Tavo në detyrën e Ministrit të Shëndetësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 33/2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 4, DATË 16.9.2009 "PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE, BYROSË DHE PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 55 pika 1 dhe nenit 8 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë "Lëvizja Socialiste për Integrim",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 4, datë 16.9.2009 "Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve, byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit", të ndryshuar, në pikën II bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Nasip Naço zgjidhet Zëvendëskryetar i Kuvendit në vend të deputetit Vangjel Tavo.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 34/2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 "PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 "Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, në pikën I bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Vath Tabaku caktohet anëtar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

II. Deputetja Lajla Pernaska caktohet anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar datë 28.6.2012.

VENDIM
Nr. 389, datë 30.5.2012

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË FINANCAVE PËR PËRDORIMIN E FONDEVE NGA LLOGARIA E SHPRONËSIMEVE PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT NR. 44, DATË 17.3.2011 TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR PUKË, ME OBJEKT "KTHIM SHUME NGA SHPRONËSIMI, SI DHE DËMSHPËRBLIM"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të aktit normativ nr. 6, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në ligjin nr. 10 190, datë 4.12.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Ministrisë së Financave, të përdorë fondin nga llogaria e shpronësimeve për interesa publikë për likuidimin e detyrimeve nga zbatimi pjesor i vlerës së vendimit civil nr. 44, datë 17.3.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në favor të kreditorëve "Pjetër Lula e të tjerë, përfaqësuar me prokurë nga Ndue Marashi", me objekt "Kthim shume nga shpronësimi, si dhe dëmshpërblim", sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe për të gjitha shpenzimet gjyqësore e tarifën përmbarimore.

2. Ekzekutimi i këtij vendimi bëhet nga Ministria e Financave, nëpërmjet zyrës së përmbarimit.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi për shumën 52 272 721 (pesëdhjetë e dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet e një) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave për shpronësimet, në Bankën e Shqipërisë, ndërsa shpenzimet gjyqësore për shumën 1 038 350 (një milion e tridhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë, si dhe tarifa përmbarimore përkatëse të përballohen nga shpenzimet korente të Ministrisë së Financave.

4. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr.	Emrat				Shuma për shpronësimin	Shpenzimet gjyqësore	Totali i shumës
1	Pjeter	Vat	Lula		1,012,228	27,325	1,039,553
2	Fran	Ndoc	Lula		1,621,783	27,325	1,649,108
3	Bafti	Marash	Ndou		876,415	27,325	903,740
4	Uke	Marash	Pjetri		1,883,870	27,325	1,911,195
5	Tom	Jak	Binaku		1,552,064	27,325	1,579,389
6	Zef	Jak	Binaku		1,553,550	27,325	1,580,875
7	Mhill	Jak	Binaku		2,005,599	27,325	2,032,924
8	Gjon	Ndue	Bushi		3,089,952	27,325	3,117,277
9	Nike	Mark	Nika		1,846,045	27,325	1,873,370
10	Stak	Mark	Nika		853,188	27,325	880,513
11	Ndue	Pal	Kacoli		1,652,410	27,325	1,679,735
12	Dede	Sokol	Nikoll	Marashi	1,449,947	27,325	1,477,272
13	Marash	Pal	Kacoli		1,361,102	27,325	1,388,427
14	Mhill	Nik	Prela		1,666,066	27,325	1,693,391
15	Marash	Zef	Marku	Marashi	1,771,748	27,325	1,799,073
16	Zef	Shan	Gjergj	Vata	1,703,805	27,325	1,731,130
17	Gjovalin	Pal	Gjergj	Vata	1,051,238	27,325	1,078,563
18	Sokol	Pal	Gjergj	Vata	1,347,964	27,325	1,375,289
19	Mirash	Pal	Gjergj	Vata	1,131,360	27,325	1,158,685
20	Kol	Bardhok	Ded	Delia	925,666	27,325	952,991
21	Lush	Kol	Frroku		923,626	27,325	950,951
22	Ndue	Ded	Gjeloshi		1,368,553	27,325	1,395,878
23	Ndue	Pashk	Ndoc	Ndou	540,379	27,325	567,704
24	Shan	Ndoc	Ndou		959,745	27,325	987,070
25	Gjon	Pal	Marashi		2,072,993	27,325	2,100,318
26	Mehill	Marash	Mehilli		1,173,719	27,325	1,201,044
27	Martin	Pjeter	Binaku		1,072,756	27,325	1,100,081
28	Mark	Zef	Ndou		1,444,272	27,325	1,471,597
29	Vat	Martin	Lula		1,140,805	27,325	1,168,130
30	Ndue	Frrok	Kola		2,070,986	27,325	2,098,311
31	Kole	Ded	Ndou		2,223,140	27,325	2,250,465
32	Shan	Ndue	Gjergj	Vata	250,072	27,325	277,397
33	Ndue	Nik	Ndou		1,271,609	27,325	1,298,934
34	Kol	Vat	Lula		486,396	27,325	513,721
35	Zef	Prel	Kola		1,137,570	27,325	1,164,895

36	Ndue	Martin	Marashi	Martini	1,088,214	27,325	1,115,539
37	Martin	Ndue	Marku	Lula	1,209,905	27,325	1,237,230
38	Pjeter	Palok	Kola		1,481,991	27,325	1,509,316
	Totali				**52,272,721**	**1,038,350**	**53,311,071**

VENDIM
Nr. 390, datë 6.6.2012

PËR PËRCAKTIMIN E SUBJEKTEVE QË KANË TË DREJTËN E AKSESIT NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ALBSReP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjektet që kanë të drejtën e aksesit në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP), në Zyrën Vendore të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë dhe që paraqesin kërkesë për pajisjen me kod hyrës, janë:

a) Ministria e Brendshme;

b) Prokuroria e Përgjithshme;

c) Prokuroritë pranë gjykatave dhe rretheve gjyqësore;

ç) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;

d) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

dh) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

e) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

ë) Bashkia e Tiranës;

f) Noterët.

2. Përdorimi i regjistrit elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP) udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë, proporcionalitetit, mbrojtjes së interesit publik dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Regjistri elektronik i pasurive të paluajtshme (ALBSReP), aksesohet vetëm nga një person i caktuar, duke njoftuar paraprakisht në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, i cili pajiset me kodin e hyrjes. Në asnjë rast kodi hyrës nuk mund t'u bëhet i ditur personave të tretë, të ndryshëm nga personi i caktuar, duke njoftuar paraprakisht pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

4. Noterët aksesojnë regjistrin e pasurive të paluajtshme (ALBSReP) për të lexuar dhe printuar informacionin për dokumentet digjitale që tregojnë gjendjen juridike të pronës.

5. Subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, kanë detyrimet e mëposhtme:

a) të njoftojnë të dhënat e personit të vetëm që do të aksesojë regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP) dhe që do të disponojë kodin e hyrjes në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme;

b) të identifikojnë pajisjen fundore, nga e cila aksesohet regjistri elektronik i pasurive të paluajtshme(ALBSReP);

c) të përdorin regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP), vetëm për qëllime të përmbushjes së detyrave të tyre funksionale dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi, për mbrojtjen e të dhënave personale;

ç) të sigurojnë me shpenzimet e tyre pajisje të identifikimit personal dhe të aksesojnë regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP), vetëm nëpërmjet këtyre pajisjeve;

d) të paguajnë shpenzimet e domosdoshme për sigurimin e aksesit dhe për mirëmbajtjen e sistemit në lidhje në sigurimin e aksesit.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 10.6.2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 393, datë 20.6.2012

PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 285, DATË 4.5.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS REFERUESE MUJORE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE DHE TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE, SIPAS NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARISË EKONOMIKE, PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN JOPUBLIK, QË KRYEJNË PUNË TË PAKUALIFIKUARA E TË KUALIFIKUARA, SI DHE PËR PERSONELIN DREJTUES E TEKNIKO-EKONOMIK TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Revokimin e vendimit nr. 285, datë 4.5.2007 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik, që kryejnë punë të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues e tekniko-ekonomik të tyre".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 394, datë 20.6.2012

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR AVOKATIN E POPULLIT, PËR FINANCIMIN E KONFERENCËS SË OMBUDSMANËVE TË VENDEVE FRËNGJISHTFOLËSE, QË ZHVILLOHET NË TIRANË, NË TETOR 2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Avokatit të Popullit, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t'i shtohet fondi 20 000 (njëzet mijë) euro, për financimin e Konferencës së Ombudsmanëve të vendeve frëngjishtfolëse, që zhvillohet në Tiranë në tetor të vitit 2012.

2. Ky fond të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë, të datës kur do të bëhen pagesat dhe i transferohet Avokatit të Popullit.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Avokati i Popullit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 395, datë 20.6.2012

PËR TRAJTIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT DHE PËRFITIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE NGA KJO KATEGORI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Viktimat e trafikimit përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Kontributi në fondin e sigurimeve shëndetësore për viktimat e trafikimit paguhet nga shteti në përputhje me nenin 34 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për pajisjen e viktimave të trafikimit me dokumentin zyrtar sipas formatit të përcaktuar në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", ky vendim shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nr. _____prot., datë __.__.__

Shërbimi Social Shtetëror Nr. ___prot., datë___.___.___

VËRTETIM

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 27.7.2011 "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit", bazuar në formatin e konkludimit, hartuar nga _____ dhe _____, vërtetojmë se _____, e bija/i biri _____, lindur më _____, në _____, është viktimë trafikimi.

Ky vërtetim është i vlefshëm deri në një vit nga data e lëshimit.

Ky vërtetim lëshohet për efekt dokumenti.

Drejtori i Policisë së Qarkut

_____

Drejtori i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror

_____

VENDIM
Nr. 396, datë 20.6.2012

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË TUFINËS, FAZA II, NË BASHKINË E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike të Tufinës, faza II, në Bashkinë e Tiranës.

2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 4090 (katër mijë e nëntëdhjetë) m² truall, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendim, e cila është pjesë përbërëse e tij.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 30 560 000 (tridhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës, për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 4090 (katër mijë e nëntëdhjetë) m² truall, shpronësuar në favor të Bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Bashkia e Tiranës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNA MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAT QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË TUFINËS, FAZA II, NË BASHKINË E TIRANËS

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqe m²	Çmimi në lekë	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit	Nr. i pasurisë
1	Shyqyri Osman Qefalia	3150	8000	25 200 000	Certifikatë pronësie	26/20
2	Bukurije Shtishi	167,5	8000	1 340 000	Certifikatë pronësie	26/29
3	Ilirjana Qemal Xhafaj Shtishi	167,5	8000	1 340 000	Certifikatë pronësie	26/29
4	Anila Qemal Nikaj (Shtishi)	167,5	8000	1 340 000	Certifikatë pronësie	26/29
5	Dylbere Qemal Muça (Shtishi)	167,5	8000	1 340 000	Certifikatë pronësie	26/29
6	Shtet	270	8000	0	Konfirmuar nga ZRPP-ja	26/30
	Totali	**4090**		**30 560 000**		

VENDIM
Nr. 399, datë 20.6.2012

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 15.3.2012, PËR ÇËSHTJEN NR. 10810/05 "ÇAUSH DRIZA KUNDËR SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", si dhe të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.3.2012, për çështjen nr. 10810/05 "Çaush Driza kundër Shqipërisë", për kompensimin fizik të pronës me sipërfaqe 360 (treqind e gjashtëdhjetë) m².

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

3. Autorizohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për kompensimin fizik të pronës, me sipërfaqe 360 (treqind e gjashtëdhjetë) m², në favor të z. Çaush Driza.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 401, datë 20.6.2012

PËR KRIJIMIN E AKADEMISË SË ARTEVE, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, 9, 41, 76 e 77 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Krijimi dhe misioni i Akademisë së Arteve, Shkodër

1. Krijimin e Akademisë së Arteve, Shkodër, si institucion publik i arsimit të lartë, e cila do të ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Shkodrës.

2. Misioni i Akademisë së Arteve, Shkodër, përfshin:

a) ofrimin e studimeve universitare në fushën e artit dhe kulturës;

b) zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;

c) formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës;

ç) thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit dhe kulturës;

d) kryerjen e kërkimeve shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën;

dh) ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë, si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

II. Struktura akademike e Akademisë së Arteve, Shkodër

Struktura akademike e Akademisë së Arteve, Shkodër, përfshin njësitë kryesore, si më poshtë:

a) Fakulteti i Muzikës, me këtë përbërje si njësi bazë:

i) Departamenti i Disiplinave Instrumentale;

ii) Departamenti i Kompozicion-Dirigjimit;

iii) Departamenti i Artit Vokal.

b) Fakulteti i Artit Figurativ, me këtë përbërje në njësi bazë:

i) Departamenti i Artit Figurativ;

ii) Departamenti i Pikturës;

iii) Departamenti i Artit Grafik.

III. Programet e studimeve të Akademisë së Arteve, Shkodër

Akademia e Arteve, Shkodër, ofron programet e mëposhtme të studimit, si dhe çdo program tjetër të miratuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore:

a) Fakulteti i Muzikës ofron:

i) programet e studimit të ciklit të parë në "Violinë";

ii) programet e studimit të ciklit të parë në "Piano";

iii) programet e studimit të ciklit të parë në "Kanto";

iv) programet e studimit të ciklit të parë në "Kompozicion";

v) programet e studimit të ciklit të parë në "Dirigjim".

b) Fakulteti i Artit Figurativ ofron programet e studimit të ciklit të parë në "Pikturë".

c) Programi i studimit të ciklit të parë në "Pikturë-Grafikë", që ofrohet aktualisht nga universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, transferohet në Fakultetin e Artit Figurativ të Akademisë së Arteve, Shkodër.

IV. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Studentët, të cilët kanë filluar programin e studimit të ciklit të parë në "Pikturë-Grafikë", në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në përfundim të studimeve do të pajisen me diplomë universitare përkatëse, të lëshuar nga universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

2. Akademia e Arteve, Shkodër, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Akademia e Arteve, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 404, datë 20.6.2012

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË PËRFITIMIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR, NGA PERSONAT ME STATUSIN E TË VERBRIT DHE INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, PËR FATURËN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE FATURËN E TELEFONISË FIKSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të nenit 12 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.

2. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.

3. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar dhe individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestarë, u jepet një kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në muaj.

4. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

5. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të cilët kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

6. Masa e kompensimit llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individi i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin.

7. Përfituesit, objekti i këtij vendimi, përjashtohen nga kompensimi i çmimit të energjisë elektrike, të parashikuar në vendimin nr. 565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”.

8. Për përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse, të përcaktuara sipas pikave 1, 2, 3, 4 e 5 të këtij vendimi, individët duhet të paraqesin pranë administratorëve shoqërorë në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për të përfituar kompensim dhe deklaratën sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) certifikatë familjare, që vërteton se individi është anëtar i familjes, e cila rinovohet çdo fillim viti;

c) kopjen e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike;

ç) kopjen e librezës së energjisë elektrike, e cila dorëzohet çdo fillim viti;

d) kopjen e kontratës me entin e shërbimit të telefonisë fikse;

dh) kopjen e librezës së telefonisë fikse, e cila dorëzohet çdo fillim viti.

e) kopje të librezave të paraplegjikut dhe tetraplegjikut apo të verbërisë, të lëshuara nga Shërbimi Social Shtetëror.

9. Njësitë e qeverisjes vendore i shpërndajnë pagesat për kompensimin e faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse nga shërbimet bankare ose “Posta Shqiptare” sh.a.

10. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2012, të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

11. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzimin përkatës të këtij vendimi.

12. Vendimi nr. 83, datë 26.2.2001 i Këshillit të Ministrave “Për tarifat telefonike dhe për pagesat elektrike nga personat me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar, shfuqizohet.

13. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Qarku_____
Njësia e qeverisjes vendore (bashkia, komuna)_____

DEKLARATË

Për efekt të kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe telefonisë fikse

I nënshkruari _____deklaroj nën përgjegjësinë time personale
(emri, atësia, mbiemri)
sa më poshtë vijon:

Jam individ, përfitues i statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar”/individët, përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, jam banor i bashkisë/komunës_____
me adresë _____, (adresa e plotë).
Kam kontratë me degën e shitjes së energjisë, e cila ka numrin _____
(numri gjendet te fatura ose libreza)
Kam kontratë me degën e shitjes së telefonisë fikse, e cila ka numrin_____
(numri gjendet te fatura ose libreza)

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	K/familjari (lidhja e të verbrit/paraplegjikut dhe tetraplegjikut me të)	Ditëlindja	Përfiton nga skema e kompensimit të energjisë/telefonisë fikse

- Deklaroj se nuk kam detyrime të papaguara ndaj degës së shitjes së energjisë elektrike/telefonisë fikse.

- Deklaroj se të dhënat janë të vërteta dhe në rast se vërtetohet e kundërta, unë do të kthej kompensimin dhe do të mbaj përgjegjësi sipas ligjit.

Deklaruesi shoqëror **Administratori**

_____

_____

_____më___/___/___

(vendi dhe data)

VENDIM
Nr. 408, datë 27.6.2012

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR BULEVARDI "BAJRAM CURRI" DERI NË RRUGËN "ALI DEMI", FAZA E DYTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë truall dhe objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor bulevardi "Bajram Curri" deri në rrugën "Ali Demi", faza e dytë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë vijon:

- për sipërfaqen 930 (nëntëqind e tridhjetë) m^2 (tokë truall), me vlerë 27 740 970 (njëzet e shtatë milionë e shtatëqind e dyzet mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë;

- për objekte me sipërfaqe 767 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) m^2, me çmimet e konfirmuara prej ZRPP-së, me vlerë 94 987 734.4 (nëntëdhjetë e katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë katër) lekë.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 445 000 (katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Bashkia e Tiranës.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 122 728 704.4 (njëqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e katër pikë katër) lekësh të përballohet nga Bashkia e Tiranës, prej fondit të miratuar nga Këshilli Bashkiak i Tiranës.

6. Për pasurinë nr. 8/507, në pronësi të bashkëpronarëve Burreli, të bëhet likuidimi pas paraqitjes së dokumentacionit të pronësisë, si dhe pasi të jetë liruar prona nga barrët përkatëse hipotekore, fakt, i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga ZVRPP-ja.

7. Për pasurinë nr. 8/271, në pronësi të bashkëpronarëve Puci, të bëhet likuidimi pas mbarimit të regjistrimit të pasurisë në ZVRPP dhe pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë të pronësisë, me të gjitha të dhënat, sipas listës bashkëlidhur.

8. Shpronësimi të fillojë më 1.7.2012.

9. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim nga ZRPP-ja", do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë së Tiranës.

10. Bashkia e Tiranës të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas pikave 6, 7 dhe 9 të këtij vendimi.

11. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Bashkia e Tiranës dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

12. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
BULEVARDI "BAJRAM CURRI", RRUGA "ALI DEMI", FAZA II

LLOGARITJET PARAPRAKE PËR SHPRONËSIM TË PASURIVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT BULEVARDI "BAJRAM CURRI"-"ALI DEMI"

Nr.	Pronari	ZK	Nr. pas.	Truall			Objekt			Vlera totale, lekë	Statusi juridik i pronës	Përshkrim i veçantë
				Sip. m^2	Çmimi	Vlera në lekë	Sip. m^2	Çmimi	Vlera në lekë			
1	Sabrie, Genci dhe Bashkim Burreli	8150	8/507	175	29829	5220075				5220075	Konfirmuar nga ZVRP-ja/certifikatë pronësie	Bllokim hipotekor në favor të BTA-së
2	Bashkëpronarët Puci	8150	8/271	162.4	29829	4844229.6	81			14875528.8	Rikonfirmim	Proces regjistrimi
3	Bashkëpronarët Fazlla	8150	8/634	380	29829	11335020	197	123843.2	24397110.2	35732130.4	Konfirmuar nga ZVRP-ja/certifikatë pronësie	Sip. totale objekti 196.7 m^2 (banesë 1-katëshe)
4	Drita Lama, Esma Bimo, Isa Gorica dhe Flutura Myftiu	8150	8/420	7.6	29829	226700.4				226700.4	Konfirmuar nga ZVRP-ja/në proces regjistrimi	Objekti nuk preket
5	Riza Hasanaj	8150	8/419	40	29829	1193160	41	123843.2	123843.2	6270731.2		E konfirmuar nga ZRPP-ja
6	Bashkëpronarët Kycyku, Balla etj. (9 BP)	8150	8/64-ND				163	123843.2	20186441.6	20186441.6	Konfirmuar nga ZVRP-ja/certifikatë pronësie	Sip. totale objekti 163 m^2 (ndërtesë 1-katëshe/3 dhoma me nga një depo secila)
7	Bashkëpronarët Kycyku, Balla etj. (9 BP)	8150	8/741	120	29829	3579480				3579480	Konfirmuar nga ZVRP-ja/certifikatë pronësie	

8	Bashkëpronarët Pengili	8150	8/754-ND				50	123843.2	6192160	6192160		E konfirmuar nga ZRPP-ja
9	Njazi dhe Mynevere Cuadari	8150	8/756-ND				145	123843.2	17957264	17957264	Konfirmuar nga ZVRP-ja/certifikatë pronësie	E konfirmuar nga ZRPP-ja
10	Bashkëpronarët Mema	8150	8/644	45	29829	1342305				1342305		E konfirmuar nga ZRPP-ja
11	Bashkëpronarët Zhupani, Hyka dhe Fida	8150	8/557-ND				90	123843.2	11145888	11145888	Konfirmuar nga ZVRP-ja/certifikatë pronësie	Sip. totale 90 m^2 ndërtesë shtëpi
	TOTALI			**930**		**27740970**	**767**		**94987734.4**	**122728704.4**		

VENDIM
Nr. 410, datë 27.6.2012

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË NDRYSHIMIT TË KATEGORIVE TË RESURSEVE TË TOKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ndryshimi i tokave bujqësore në kategori të resurseve të tjera dhe anasjelltas", veprimet procedurale e dokumentare dhe miratimet që bëhen nga strukturat shtetërore, të përcaktuara në këtë vendim, që sjellin për pasojë ndryshimin e tokës bujqësore në kategori të resurseve të tjera apo ndryshimin e kategorive të resurseve të tjera në tokë bujqësore. Ky ndryshim pasqyrohet në dokumentacionin kadastral shtetëror.

2. "Subjekte të interesuara për ndryshimin e kategorive të resurseve":

a) personat, fizikë a juridikë, të cilët e kanë në pronësi private tokën bujqësore, tokën me bimësi pyjore, pyllin, kullotën, livadhin, tokën e pafrytshme dhe që shprehin interes apo kërkojnë ndryshimin nga një kategori resursi në një kategori tjetër;

b) organet e qeverisjes vendore apo institucione të tjera shtetërore që, bazuar në akte ligjore ose nënligjore, kanë në administrim/përdorim apo në pronësi tokën bujqësore, tokën me bimësi pyjore, kullotën, livadhin, tokën e pafrytshme, sipërfaqe të brigjeve të lumenjve, sipërfaqe këto në pronësi shtetërore (publike) dhe që shprehin interes apo kërkojnë ndryshimin e një kategorie resursi në një kategori tjetër.

3. "Subjekte të interesuara për ndryshim të tokës bujqësore në tokë urbane (truall), në tokë për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore dhe karriera":

a) personat, fizikë a juridikë, që ushtrojnë kërkesën pranë ministrive përkatëse që mbulojnë këto veprimtari;

b) ministritë përkatëse dhe autoritetet e planifikimit, që kanë kompetencë dhe përgjegjësi për planifikimin e territorit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. "Subjekte të interesuara për kalimin e tokave bujqësore të kategorive nga I deri në IV të bonitetit për ushtrim të veprimtarive të domosdoshme":

a) personat, fizikë a juridikë, që kërkojnë zhvillimin e veprimtarisë mbi këto toka;

b) ministritë përkatëse që mbulojnë veprimtarinë për të cilën kërkohet kalimi.

II. NDRYSHIMI I TOKAVE NGA KATEGORITË E RESURSEVE PYLL, TOKË ME BIMËSI PYJORE, KULLOTË DHE LIVADH NË KATEGORINË E RESURSIT TOKË BUJQËSORE

1. Subjekti i interesuar për ndryshimin e kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë e livadh dhe kalimin e tyre në tokë bujqësore, mund të paraqesë kërkesë në njësinë e qeverisjes vendore, ku ndodhen këto sipërfaqe, e cila përmban:

- identitetin e kërkuesit;
- dokumentin e noterizuar të disponimit të këtyre resurseve në pronësi, sipas ligjit;
- planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet ndryshimi, me kufijtë qartësisht të përcaktuar në shkallën 1: 2500;

- vërtetimin për gjendjen e kategorisë së resursit, me të cilën figuron kjo sipërfaqe në dokumentacionin kadastral, të lëshuar përkatësisht nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor (DSHP) apo Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) e qarkut;

- projektin e hollësishëm e të argumentuar për veprimtarinë që do të ushtrojë në sipërfaqen e kërkuar për ndryshim të kategorisë së resursit.

2. Komisioni i ndryshimit të kategorive të resurseve, i komunës ose bashkisë, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të tij, e shqyrton kërkesën brenda afateve të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 4 të nenit 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, të ndryshuar, dhe merr vendimin përkatës.

3. Në rastin e miratimit të ndryshimit të kategorive të resurseve objekt kërkese dhe të kalimit të tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore, vendimi përgatitet në 4 (katër) kopje, nga të cilat një kopje i jepet subjektit kërkues, një kopje mbahet në ZMMT-të e komunës ose bashkisë, një kopje i dërgohet DAMT-së së qarkut dhe kopja e katërt i dërgohet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, në bazë të së cilës kryhen veprimet e përcaktuara në kreun VIII të këtij vendimi.

4. Në rastin e mosmiratimit të kërkesës për ndryshim të kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadhe për kalimin e tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore, për sipërfaqen e plotë apo sipërfaqen e pjesshme objekt kërkese, vendimi me shkrim i komunikohet subjektit kërkues, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së tij. Në vendim pasqyrohen shkaqet e mosmiratimit të kërkesës.

5. Subjekti që ka paraqitur kërkesë për ndryshim të kategorive të resurseve, si në rastin kur komisioni i komunës ose bashkisë e rrëzon kërkesën, siç përcaktohet në pikën 4 të këtij kreu, ashtu edhe në rastet kur komuna ose bashkia nuk e kanë marrë atë në shqyrtim brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga regjistrimi i saj, ka të drejtë ta paraqesë këtë kërkesë për vendimmarrje në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK).

6. Struktura përgjegjëse e administrimit të tokave në MBUMK e shqyrton kërkesën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dhe në rastin kur ajo është në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj e me procedurat e përcaktuara në pikat 1 deri 5 të këtij kreu, e vlerëson atë për t'u miratuar dhe ia dërgon për mendim Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), e cila shprehet me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Kur mendimet e të dyja ministrive rezultojnë me vlerësim të njëjtë për miratimin e ndryshimit të kategorisë së resursit, struktura përgjegjëse e administrimit të tokës në MBUMK përgatit urdhrin e ministrit për miratim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e mendimit të MMPAU-së.

Urdhri i ministrit i njoftohet subjektit kërkues dhe i dërgohet për zbatim komunës ose bashkisë dhe DAMT-së së qarkut.

III. NDRYSHIMI I TOKËS BUJQËSORE NË KATEGORI TË RESURSEVE PYLL, KULLOTË DHE LIVADH

1. Tokat bujqësore të kategorive nga I deri në IV të bonitetit nuk lejohet të kalojnë në kategori të resurseve pyll, kullotë dhe livadh.

2. Kur subjekti i interesuar për ndryshimin e kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategori të resurseve pyll, kullotë dhe livadh është pronar privat, e paraqet kërkesën në MBUMK, e cila përmban:

- identitetin e kërkuesit;
- përshkrimin e veprimtarisë që do të ushtrojë në sipërfaqen e kërkuar për kalim;
- fotokopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë mbi tokën;
- planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet kalimi, me kufijtë e saj qartësisht të dallueshëm;
- vërtetimin origjinal, të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) e qarkut, për kategorinë e resursit me të cilën figuron kjo sipërfaqe në dokumentacionin kadastral dhe për kategorinë e tokës sipas bonitetit.

3. Kur subjekti kërkues për ndryshimin e kategorisë së resursit tokë bujqësore, në pronësi të shtetit është organi i qeverisjes vendore, që me akte ligjore ose nënligjore i disponon këto sipërfaqe në administrimin/përdorimin, ia paraqet kërkesën për kalim të tyre në kategori të resurseve pyll, kullotë dhe livadh MBUMK-së. Kërkesa përmban:

- identitetin e subjektit të interesuar për ndryshimin e tokës bujqësore në kategori të resurseve të tjera;

- përshkrimin e qëllimit dhe veprimtarisë që do të ushtrohet në sipërfaqen e kërkuar për ndryshimin;

- fotokopjen e aktit ligjor ose nënligjor, që vërteton qenien në administrim apo përdorim të sipërfaqes së tokës për të cilën kërkohet ndryshimi;

- planimetrinë e sipërfaqes, objekt të propozimit, me kufijtë qartësisht të përcaktuar;

- vërtetimin e DAMT-së për kategorinë e resursit, me të cilën figuron kjo sipërfaqe në dokumentacionin kadastral, si dhe për kategorinë e tokës sipas bonitetit.

4. Struktura që mbulon administrimin e tokave në MBUMK shqyrton kërkesën e paraqitur, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga regjistrimi i saj, në lidhje me ligjshmërinë, dokumentacionin përbërës dhe efektivitetin ekonomik që rrjedh nga ndryshimi i kategorisë së resursit, në përputhje me programet mbështetëse të qeverisë për bujqësinë.

Në çdo rast të vlerësimit pozitiv të kërkesës, kjo strukturë përgatit:

a) urdhrin e ministrit për miratimin e ndryshimit të kategorisë së resursit të tokës bujqësore dhe kalimin e saj përkatësisht në kategorinë e resursit pyll, kullotë dhe livadh, kur sipërfaqja që propozohet për kalim është deri në 5 (pesë) ha;

b) projektvendimin e Këshillit të Ministrave, kur sipërfaqja e tokës bujqësore që propozohet për kalim në kategoritë e resurseve pyll, kullotë apo livadh është mbi 5.1 ha.

5. Kur ministri vlerëson se kërkesa nuk i përmbush kriteret e përcaktuara, gjë që sjell, për pasojë, mosmiratimin e saj brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, njofton subjektin që ka paraqitur kërkesën.

IV. NDRYSHIM I TOKËS SË PAFRYTSHME NË KATEGORINË E RESURSIT TOKË BUJQËSORE

1. Subjekti i interesuar për ndryshim të kategorisë së tokës së pafrytshme dhe kalimin e saj në kategorinë e resursit tokë bujqësore, e paraqet kërkesën pranë Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Fushë-Krujë, si institucion unik dhe i specializuar në këtë fushë, për kryerjen e analizave të tokës. Kërkesa përmban:

- identitetin e kërkuesit;

- dokumentin e noterizuar të disponimit të këtyre resurseve në pronësi, sipas ligjit;

- planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet ndryshimi, me kufijtë qartësisht të përcaktuar;

- vërtetimin për gjendjen e kategorisë së resursit me të cilën figuron kjo sipërfaqe në dokumentacionin kadastral, të lëshuar përkatësisht nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor (DSHP) apo Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) e qarkut.

2. Kërkesa për kryerjen e analizave të tokës regjistrohet në QTTB. Kësaj kërkese i bashkëngjitet mandatpagesa që bën subjekti i interesuar, në të cilën përfshihet vlera e analizave, sipas tarifave të miratuara për QTTB-në, dhe shpenzimet për punën e grupit të ekspertëve.

Në shpenzimet e punës së grupit të ekspertëve përfshihen dietat e udhëtimit, sipas dispozitave në fuqi, dhe shpenzimet për hapje profilesh e marrje mostrash.

Numri i profileve dhe i mostrave, që merren në sipërfaqen që analizohet dhe vlerat përkatëse përcaktohen sipas udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Subjekti kërkues, pasi ka marrë rezultatet e analizave dhe raportin teknik nga QTTB-ja, me rekomandimin dhe vlerësimin për mundësinë e kalimit të sipërfaqes së tokës së pafrytshme në tokë bujqësore, i drejtohet me kërkesë MBUMK-së.

Kërkesa shoqërohet me dokumentet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu dhe me një informacion për veprimtarinë që do të ushtrojë në sipërfaqen objekt të kërkesës.

4. Struktura që mbulon administrimin e tokave në MBUMK shqyrton kërkesën e paraqitur, në lidhje me ligjshmërinë, dokumentacionin përbërës, efektivitetin ekonomik që rrjedh nga ndryshimi i kategorisë së resursit, në përputhje me programet mbështetëse të qeverisë për bujqësinë.

5. Në rastin e vlerësimit pozitiv të kërkesës, MBUMK-ja përgatit urdhrin e ministrit për miratimin e ndryshimit të kërkuar. Kur ministri vlerëson se në kërkesë nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara, që sjellin për pasojë mosmiratimin e saj brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, njofton subjektin që ka paraqitur kërkesën.

V. NDRYSHIMI I TOKËS BUJQËSORE NË KATEGORINË E RESURSIT TOKË E PAFRYTSHME

1. Subjekti i interesuar për ndryshimin e kategorisë së resursit tokë bujqësore dhe kalimin e saj në kategorinë e resursit tokë e pafrytshme, ka të drejtë kërkese për ndryshim vetëm kur mbi këtë sipërfaqe toke bujqësore kanë vepruar faktorët natyrorë të fuqisë madhore, si: tërmete, rrëshqitje masive të sipërfaqeve të tokës, përmbytje, vullkane, zjarre masive, fundosje të shtresave të tokës dhe të tjerë faktorë të kësaj natyre.

Veprimi i faktorëve natyrorë të fuqisë madhore kërkohet të jetë i dokumentuar me procesverbalin e kohës së dëmtimit, të konfirmuar (nënshkruar) nga specialisti i DRB-së, inspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës (IMT), në qark dhe përgjegjësi i ZMMT-së në komunë a bashki ose të jetë i dokumentuar nga IMT-ja, sipas procedurave të përcaktuara në pikat 5 deri në 8 të kreut IV të vendimit nr. 80, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore".

2. Dëmtimi i tokës bujqësore nga faktorë të fuqisë madhore, të evidentuara sipas pikës 1 të këtij kreu, verifikohet nëpërmjet analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore, që kryhen nga QTTB-ja, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të kreut IV të këtij vendimi.

Kërkesës për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës, veç përmbajtjes së përcaktuar në pikën 1 të kreut IV të këtij vendimi, i shtohet edhe dokumentacioni që evidenton dëmtimin e tokës, i mbajtur sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij kreu.

3. Subjekti i interesuar për ndryshimin e tokës bujqësore dhe kalimin e saj në kategori të resursit tokë e pafrytshme, në varësi të rezultateve të analizave, raportit teknik dhe rekomandimeve të QTTB-së, mund të paraqesë kërkesë në MBUMK.

4. Struktura që mbulon administrimin e tokave në MBUMK shqyrton mbështetjen ligjore të kërkesës dhe dokumentacionin përbërës të tij.

Në rastin e vlerësimit pozitiv të kërkesës, MBUMK-ja përgatit:

a) urdhrin e ministrit për miratimin e ndryshimit, kur sipërfaqja objekt kërkese është deri në 5 (pesë) ha;

b) vendimin e Këshillit të Ministrave, kur sipërfaqja objekt kërkese është mbi 5.1 (pesë pikë një) ha.

Kur ministri vlerëson se në kërkesë nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara, që sjellin, për pasojë, mosmiratimin e saj, njofton subjektin që ka paraqitur kërkesën.

VI. NDRYSHIMI I TOKAVE BUJQËSORE TË KATEGORIVE NGA V DERI NË X TË BONITETIT DHE KALIMI I TYRE NË TOKË URBANE (TRUALL), NË TOKË PËR VEPRIMTARI MINERARE E GJEOLOGJIKE, SI DHE PËR GURORE E KARIERA

1. Subjektet e interesuara për ndryshim të kategorisë së resursit të tokës bujqësore, nga V deri në X të bonitetit, për kalimin e tyre në tokë urbane (truall), në tokë për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore dhe karriera, paraqesin kërkesë në ministrinë përkatëse që mbulon këtë veprimtari. Kërkesa paraqitet sipas dispozitave të legjislacionit për planifikimin e territorit.

Kërkesa përmban edhe vërtetimin për kategorinë e tokës sipas bonitetit, për sipërfaqen objekt kërkese, të lëshuar nga DAMT-ja në këshillin e qarkut.

2. Ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse merr, paraprakisht, mendimin e MBUMK-së dhe përgatit vendimin e Këshillit të Ministrave, kur kërkesa ka për objekt sipërfaqe toke deri 30 (tridhjetë) ha, apo ligjin kur kërkesa ka për objekt sipërfaqe toke mbi 30 (tridhjetë) ha.

VII. KALIMI I TOKAVE BUJQËSORE TË KATEGORIVE NGA I DERI NË IV PËR NDËRTIME, PËR RASTE TË DOMOSDOSHME

1. Subjektet e interesuara për të ushtruar veprimtari në tokat bujqësore të kategorive nga I deri në IV të bonitetit, vetëm për rastet e domosdoshme, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, paraqesin kërkesë në ministrinë që mbulon veprimtarinë përkatëse, sipas dispozitave që rregullojnë veprimtaritë për planifikimin e territorit.

Kërkesa duhet të përmbajë edhe vërtetimin për kategorinë e tokës sipas bonitetit, të lëshuar nga DAMT-ja e këshillit të qarkut.

2. Ministritë përkatëse, që mbulojnë veprimtari për të cilën kërkohet kalimi i tokës, marrin paraprakisht mendimin e MBUMK-së dhe përgatitin vendimin e Këshillit të Ministrave.

VIII. PËRDITËSIMI NË DOKUMENTACIONIN KADASTRAL TË KALIMEVE DHE NDRYSHIMEVE TË KATEGORIVE TË RESURSEVE

1. DAMT-ja në këshillin e qarkut, ZMMT-ja në komunë dhe/ose bashki, DSHP-ja e rrethit, për kalimet dhe ndryshimet e kategorive të resurseve, të miratuara sipas rastit me akte ligjore apo nënligjore dhe mbështetur në to bëjnë përditësimin në dokumentacionin kadastral përkatës.

2. DAMT-ja në këshillin e qarkut dhe DSHP-ja në rreth, për kalimet dhe ndryshimet e miratuara me akte ligjore apo nënligjore njoftojnë zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rreth, e cila i pasqyron këto ndryshime në llojet e pasurive, sipas pronarëve ose poseduesve të ligjshëm të tyre.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 655, datë 28.7.2010 i Këshillit të Ministrave "Për rregullat dhe procedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, strukturat shtetërore të administrimit të tokës në qarqe dhe institucionet e tjera shtetërore të ngarkuara nga ligji për planifikimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 411, datë 27.6.2012

PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT TË ZNJ. ESMERALDA URUÇI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012" dhe të pikave 9.2 e 11.4 të kreut VII të vendimit nr. 229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përballimin e shpenzimeve të varrimit dhe të ceremonialit të organizuar për ndër të znj. Esmeralda Uruçi, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2012, për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

PREVENTIV PËR CEREMONINË E VARRIMIT TË ZNJ. ESMERALDA URUÇI

1.	Kurora me lule të freskëta	copë	1 x 20 000	= 20 000	lekë
2.	Arkivol ceremonial	copë	1 x 120 000	= 120 000	lekë
3.	Autofunerali Tiranë-Shkodër	copë	1 x 20 000	= 20 000	lekë
			Totali	**160 000**	lekë

URDHËR
Nr. 78, datë 2.7.2012

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 8 të vendimit nr. 256, datë 13.4.2010 të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë,

URDHËROJ:

Znj. Ariana Demi të emërohet zëvendësdrejtore e Përgjithshme i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Drejtore e Kthimit të Pronave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 73, datë 13.6.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE "PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TË BORXHIT TË KEQ"

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe në respektim të vendimit nr. 5690, shpallur në datën 4.6.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me "Anulimin e vendimit nr. 99, datë 30.9.2012, "Mbi miratimin e studimit të borxhit të keq", Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.6.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi se:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5690 shpallur në datën 4 qershor 2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a., duke anuluar vendimin nr. 99, datë 30.9.2011 "Për miratimin e studimit mbi borxhin e keq".

- Ministria e Financave, në cilësinë e garantuesit sipas Marrëveshjes së Mbështetjes Qeveritare (PRG), me shkresat nr. 4512/3 prot., datë 5.4.2012, dhe nr. 4512/7, datë 12.6.2012, duke konsideruar kuadrin ligjor respektiv, rekomandimet dhe korrespondencat me Bankën Botërore minimizimin e riskut të ekspozimit të vendit ndaj proceseve gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare, si dhe për të garantuar furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike ka mbështetur propozimin e Bankës Botërore për rikonsiderimin e borxhit të keq dhe niveleve përkatëse të tij sipas supozimeve të studimit, por duke përjashtuar subjektet buxhetore dhe si të tillë edhe supozimet e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e studimit të borxhit të keq.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë "CEZ Shpërndarje" sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 74, datë 15. 6.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pika 1 germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "g", 5 pika 1 germa "g", 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Albpetrol" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Albpetrol" sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10 pikat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Albpetrol" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 75, datë 15.6.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve: 3 pika 31, 8 pika 2 germa "a", 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "f", 5 pika 1 germa "f" dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.6.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Albpetrol" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Albpetrol" sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat "a", "b", "c") është paraqitur dhe plotesuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Albpetrol" sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 76, datë 15.6.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "LU & CO ECO ENERGY 2011" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "OSTREN I VOGËL"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "a", 5, pika 1 germa "a", 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.6.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "LU & CO ECO Energy 2011" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "LU & CO ECO Energy 2011" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "LU & CO ECO Energy 2011" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Ostren i Vogël" me fuqi 0.320 MW, për një afat 30-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 77, datë 15.6.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBANIAN POWER" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve: 8 pika 2 germa "a", 9 dhe 13 pika 1 germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve: 4 pika 1 germa "g", 5 pika 2, neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Albanian Power" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Albanian Power" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Albanian Power" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 78, datë 15.6.2012

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES "HEC MARTANESH" TË SHOQËRISË "ALBANIAN POWER" SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve: 8 pika 2 germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 7 dhe 9 pika 2 germa "a" të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme" të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 15.6.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Albanian Power" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për "Hec Martanesh" si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Albanian Power" sh.p.k., është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat "a", "b", "c", "d".

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat "a", "b", "c", "d".

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat "a", "b", "c".

Përshkrimi i centralit…

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues "Hec Martanesh" të shoqërisë "Albanian Power" sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Fletorja Zyrtare
e Republikës së Shqipërisë

VENDIM
Nr. 79, datë 15.6.2012

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT "FTESË PËR SHPREHJE INTERESI" QË DO TË SHPALLET NGA TAP AG NË PËRPUTHJE ME UDHËZUESIN PËR MENAXHIMIN DHE ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË PROJEKTIT TRANSADRIATIK PIPELINE (TAP), SIPAS PARAGRAFIT 6 TË NENIT 36 TË DIREKTIVËS 2009/73/EC

Në mbështetje të nenit 40 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror" dhe neni 25 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr. 107, datë 17.10.2011 të Bordit të Komisionerëve, vendimin nr. 155, datë 19.12.2011, për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga aksesi i palëve të treta, të paraqitur nga ana e kompanisë TAP AG, nenit 3 të udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin transadriatik Pipeline (TAP) të miratuar me vendimin nr. 39, datë 23.4.2012 të Bordit të Komisionerëve, duke marrë parasysh gjithashtu që:

- Direktiva 2009/73/EC është e zbatueshme për Italinë dhe Greqinë, si shtete anëtare të Bashkimit Europian dhe është transpozuar në legjislacionin përkatës kombëtar të këtyre vendeve, dhe
- Direktiva 2003/55/EC është e zbatueshme për Shqipërinë, si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe është transpozuar në legjislacionin kombëtar.
- Këshilli i Ministrave i Komunitetit të Energjisë ka vendosur më 6 tetor 2011, që direktiva 2009/73/EC dhe rregullorja 715/2009, do të duhet të zbatohen nga të gjitha palët kontraktuese brenda vitit 2015;
- Neni 22 i direktivës 2003/55/EC, neni 36 i direktivës 2009/73/EC dhe legjislacioni kombëtar, kërkojnë që në rastin kur infrastruktura në fjalë shtrihet në territorin e më shumë se një vendi, çdo vendim për përjashtim prej së drejtës të aksesit të palëve të treta (TPA), duhet të merren në bashkëpunim mes autoriteteve kombëtare të vendeve përkatëse;
- Neni 3 i udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin transadriatik Pipeline (TAP) të miratuar me vendimin nr. 39, datë 23.4.2012 të Bordit të Komisionerëve, ka përcaktuar detyrimin e miratimit nga ana e autoriteteve rregullatore, të dokumentit "Ftesë për shprehje interesi", që do të shpallet nga TAP AG, në përputhje me udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit transadriatik Pipeline (TAP).

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.6.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës, në lidhje me dokumentin "Ftesë për shprehje interesi", që do të shpallet nga TAP AG, në përputhje me udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit transadriatik Pipeline (TAP), sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC, që ka rezultuar prej bashkëpunimit të tre rregullatorëve,

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit "Ftesë për shprehje interesi", që do të shpallet nga TAP AG në përputhje me udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin transadriatik Pipeline (TAP), sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC (bashkëlidhur këtij vendimi, dokumenti "Ftesë për shprehje interesi").
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 80, datë 15.6.2012

MBI MIRATIMIN E STUDIMIT PËR BORXHIN E KEQ

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit nr. 5690, shpallur në datën 4.6.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me "Anulimin e vendimit nr. 99, datë 30.9.2012 "Mbi miratimin e studimit të borxhit të keq", pikës 5.2 të deklaratës rregullatore, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 154, datë 29.2.2012 "Për miratimin e marrëveshjes tip për fillimin e procedurave për shuarjen me kompensim të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive të kontrolluara nga shteti dhe "CEZ Shpërndarje" sh.a." Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.6.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi se:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5690, shpallur në datën 4 qershor 2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a., që kërkonte konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 99, datë 30.9.2011, duke vendosur si të tillë anulimin e vendimit nr. 99, datë 30.9.2011 "Për miratimin e studimit mbi borxhin e keq". Në kushtet e anulimit të aktit në fjalë nga ana e gjykatës, ERE mbështetur në deklaratën rregullatore pika 5.2, duhet të shprehet lidhur me pranimin ose jo të studimit për borxhin e keq, pasi pas marrjes së vendimit të gjykatës vendimi nr. 99 i Bordit të Komisionerëve nuk sjell më pasojë juridike në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative neni 117.

- Ministria e Financave në cilësinë e garantuesit, sipas Marrëveshjes së Mbështetjes Qeveritare (PRG), me shkresat nr. prot. 4512/3, datë 5.4.2012 dhe nr. prot 4512/7, datë 12.6.2012, duke konsideruar kuadrin ligjor respektiv, rekomandimet dhe korrespondencat me Bankën Botërore, minimizimin e riskut të ekspozimit të vendit ndaj proceseve gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare, si dhe për të garantuar furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike ka mbështetur propozimin e Bankës Botërore për rikonsiderimin e borxhit të keq dhe niveleve përkatëse të tij, sipas supozimeve të studimit, por duke përjashtuar subjektet buxhetore dhe jobuxhetore.

- Çështja e borxhit të keq, për të cilën është marrë vendimi nr. 99, datë 30 shtator 2011, është çështje e garantuar sipas ligjit nr. 10 126, datë 11.5.2009 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sh.a."", çështje për të cilin "CEZ Shpërndarje" ka paraqitur njoftimin e pretendimit dhe njoftimin e ngjarjes pranë Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore.

- Qeveria në shkresat me nr. prot. 4512/3, datë 5.4.2012 dhe nr. prot. 4512/7, datë 12.6.2012 të Ministrisë së Financave në cilësinë e garantorit ka mbështetur propozimin e Bankës Botërore për rikonsiderimin e borxhit të keq dhe niveleve përkatëse të tij, sipas studimit, duke përjashtuar efektin e mospagesave të subjekteve shtetërore në nivelin e borxhit të keq, me argumentin se kjo do të minimizonte riskun e ekspozimit të vendit ndaj proceseve gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare.

- Banka Botërore në rolin e palës së përfshirë në marrëveshjen e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) dhe Bankës Ndërkombëtare për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sh.a., nisur nga situata financiare e "CEZ Shpërndarje", ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nga palët (Ministria e Financave, Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ERE, "CEZ Shpërndarje" dhe KESH) ndër të tjera edhe me shkresën nr. 770 prot., datë 14.12.2011, në funksion të përmirësimit dhe për t'i dhënë frymëmarrje sektorit, rikonsiderimin prej palëve ndër të tjera të nivelit të lejuar të borxhit të keq përmes rishikimit të studimit të borxhit të keq.

- Shifrat faktike pjesore të paraqitura nga kompania gjatë gjithë kësaj periudhe dhe së fundmi me shkresën nr. prot. 2886/2, datë 13.6.2012, kanë evidentuar në përgjithësi se supozimi i bërë nga ERE në lidhje me arkëtimet e viteve 2008, 2009, 2010, aq sa është mundur të implementohen në modelin e studimit të borxhit të keq, nuk vërtetohet.

- Sipas studimit të borxhit të keq të Deloitte pjesa Përmbledhja Ekzekutive – Fakte Thelbësore – Skenari i Kompensimit Potencial mes "CEZ Shpërndarje" dhe KESH-it, Republika e Shqipërisë, nivelet e borxhit të keq për vitet 2008, 2009, 2010, janë përkatëssh: 14,86%, 16,85% dhe 19.73%. Këto nivele sipas *Deloitte* janë rezultat i një skenari kompensimi ndërmjet "CEZ Shpërndarje", KESH-it dhe institucioneve të tjera buxhetore dhe jobuxhetore, nëse do të ekzistojë një vendim detyrues ligjor dhe/ose një marrëveshje mes palëve.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 154, datë 29.2.2012, është aprovuar marrëveshja për shuarjen e detyrimeve të ndërsjella ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive të kontrolluara nga shteti. Sipas këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, Ministria e Financave është autorizuar të përdorë të gjitha procedurat shtrënguese ligjore për shlyerjen në kohë të detyrimeve ndërmjet palëve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e studimit të borxhit të keq të përgatitur nga eksperti financiar i pavarur *Deloitte*. Nivelet e borxhit të keq sipas studimit për vitet 2008, 2009, 2010, janë respektivisht 14,86%, 16,85 % dhe 19.73%.

2. Llogaritja e borxhit të keq kryhet sipas pikës 5.2 të deklaratës rregullatore.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë "CEZ Shpërndarje" sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 81, datë 22.6.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E TARIFËS SË FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014 PËR AKOMODIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE TË VENDIMIT NR. 80, DATË 15.6.2012 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

Në mbështetje të neneve: 7, 8 pika 2 germa "b", "ç" dhe "dh", nenit 26 pika 1 dhe 27 pika 1 germa "dh" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 16 pika 2 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, dhe neneve 112, 121 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.6.2012,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për rishikimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80, datë 15.6.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë "CEZ Shpërndarje" sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. 860-492, datë 7.6.2012, vendosi shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Luan Tefik Sadikaj, i datëlindjes 20.3.1929, lindur dhe banues në fshatin Buçimas, Pogradec, si dhe caktimin e shtetases Luljeta Sadikaj, si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKESË

Shtetasja Albana Gjeçi (Hoti), e bija e Asllanit dhe e Hatmanes, e datëlindjes 25.7.1977, lindur në Katundi nr. 1, Durrës dhe banuese në fshatin Qerret, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të zhdukur të motrës së saj, shtetases Florinda Asllan Hoti, e datëlindjes 3.11.1978.

KËRKUESE
Albana Gjeçi (Hoti)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 16.7.2012
Doli nga shtypi më 17.7.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 42 lekë